



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës
Opština Dakovica-Municipality of Gjakova



Plani Lokal i Menaxhimit të Mbeturinave

2015-2020

Gjakovë

Plani Lokal i Menaxhimit

të Mbeturinave

2015 – 2020

Komuna Gjakovë

Gjakovë,

Tetor 2015

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje	8
1.1 Problematika e përgjithshme e mbeturinave në Kosovë	8
2. Historik i shkurtër i Komunës.....	8
2.1 Gjendja ekzistuese	8
2.2 Rolet dhe përgjegjësitë për menaxhimin e mbeturinave	10
2.3 Operatori i menaxhimit të mbeturinave	10
2.4 Menaxhimi i Mbeturinave.....	12
2.5 Sfidat në menaxhimin e mbeturinave të cilat nuk janë në kompetencë të drejtpërdrejt të Komunës.....	13
2.6 Korniza kombëtare ligjore dhe politikat.....	14
2.6.1 Korniza lokale ligjore	15
3. Planifikimi i Menaxhimit të Mbeturinave.....	15
3.1 Fushëveprimi i planit	15
3.2 Synimet e përgjithshme PLMM-së.....	15
3.3 Fazat e zbatimit të planit 2015-2020.....	17
3.3.1 Plotësimi i kornizës lokale ligjore	17
3.4 Themelimi i sektorit të Menaxhimit të Mbeturinave	18
3.5 Zonat e shërbimit.....	18
3.6 Krijimi i sistemit financiar për menaxhimin e mbeturinave.....	20
3.7 Përmirësimi i sistemit të grumbullimit të mbeturinave.....	20
4. Plani Financiar 2015-2020.....	21
4.1 Supozimet kryesore në planin financiar.....	21
4.2 Investimet e reja të nevojshme kapitale	23
4.2.1 Supozimet kryesore për investimet e nevojshme kapitale.....	24
4.3 Mekanizmi i Vjeljes	26
4.4 Buxheti komunal i dedikuar për menaxhimin e mbeturinave.....	26
4.5 Të hyrat e planifikuara	28
5. Vlerësimi Strategjik Mjedisor.....	29
5.1 Qëllimi dhe qasja e VSM-së.....	29
5.2 Vlerësimi i masave dhe politikave të propozuara.....	30
5.3 Rekomandimet dhe propozimet e monitorimit	32
6. Ndërgjegjësimi i publikut.....	34
6.1 Strategjia e Komunikimit të Marketingut.....	34
6.1.1 Publiku/Akterët e Synuar.....	35
6.1.2 Mesazhet kuqë për promovim	35
7. Plani i Veprimeve.....	36
7.1 Qartësimi i përgjegjësive të qytetarëve, bizneseve dhe qeverisjes lokale.....	36
7.2 Përmbledhje e Planit të Zbatimit 2015-2020	37

8. Monitorimi dhe rishikimi.....	38
8.1 Përcaktimi i treguesve të përformancës dhe burimet e verifikimeve.....	38
8.2 Pilot projektet e planifikuara.....	39
8.2.1 Prezantimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave me përmasa të mëdha	39
8.2.2 Promovimi i minimizimit të mbeturinave përmes kompostimit	39
8.2.3 Promovimi i minimizimit të mbeturinave përmes klasifikimit të mbeturinave nëpër shkolla	40
8.2.4 Promovimi i minimizimit të mbeturinave përmes qeseve të najlonit	40
8.2.5 Promovimi i riciklimit të mbeturinave përmes menaxhimit të mirëfilltë të Stacionit Transferues	40
SHTOJCAT.....	41
Shtojca I: Zonimi i territorit	41
1.1 Mbulimi i zonës gjatë periudhës së planit MM 2016-2020	41
Shtojca II: Pjesa financiare	47
1.1 Plani i mbulimit për periudhën planifikuese 2015-2020 për zonën e pambuluar me shërbime të MM.....	47
1.2 Investimet e reja të nevojshme kapitale	47
1.2.1 Investimet e planifikuara për periudhën 2015-2020 për kategoritë kryesore.....	47
1.3 Amortizimi i mjeteve për transport dhe MM	47
1.3.1 Mjetet themelore (struktura e amortizimi).....	48
1.3.2 Klientët, struktura e të hyrave në bazë të kategorive të vjeljes.....	48
1.3.3 Struktura e pagave të të punësuarve në KP “Çabrat”	49
1.3.4 Shpenzimet e tatimit dhe taksat gjyqësore	49
1.3.5 Kostot e operative	49
1.3.6 Pasqyra e të ardhurave për vitin 2014.....	50
1.3.7 Struktura e të hyrave për vitin 2015.....	50
2.4 Përformanca financiare (planifikimi i rrjedhës së parave) (shtojca)	51
2.4.1 Të hyrat e projektuara të sektorit për periudhën 2015-2020	51
2.5 Tarifa	51
2.5.1 Struktura e të hyrave në bazë të kategorive kryesore të të hyrave	51
2.5.2 Përlllogaritja e kostove për grupet e klientëve.....	52
2.5.3 Përlllogaritja e për grupet e klientëve	52
Shtojca III: Njohja e zonës	53
1. Popullata	53
1.1 Numri i banorëve në bazë të zonës dhe kategorive kryesore	53
1.2 Numri i banorëve në bazë të zonës dhe në bazë të largësisë (pika referuese)	53
1.3 Numri i banorëve në bazë të zonës dhe në bazë të grup-moshave	53
1.4 Numri i banorëve në bazë të zonës dhe në bazë të grup-moshave(Urbane/Rurale)	53
1.5 Numri i banorëve në bazë të zonës dhe në bazë të largësive dhe drejtimeve	54
2. Ekonomitë familjare	55

2.1 Raporti i shpërndarjes së ekonomive familjare sipas sipërfaqeve të zonave kadastrale	55
2.2 Raporti i shpërndarjes së ekonomive familjare sipas sipërfaqeve të zonave kadastrale (enti i statistikave)	55
2.3 Raporti i shpërndarjes së ekonomive familjare sipas sipërfaqeve të zonave kadastrale (tatimi në ton)	55
2.4 Raporti i shpërndarjes së ekonomive familjare në baze të largësisë në KM nga (pika referuese KK Gjakovë)	55
3. Zonat kadastrale	56
3.1 Zonat kadastrale në baze të kategorive kryesore - SIPERFAQJA në m ²	56
3.2 Zonat kadastrale në baze të kategorive kryesore - SIPERFAQJA m ²	56
4. Tatimi në pronë	57
4.1 Numri i ekonomive familjare (të dhënat nga tatimi në pronë)	57
4.2 Sipërfaqet e objekteve në m ² - burimi tatimi në prone KK Gjakovë	57
4.3 Sipërfaqet e objekteve në m ² - burimi tatimi në pronë KK Gjakovë(largësitë e matura në KM).....	58
5. Shërbimet e MM-së sipas kategorive	59
5.1 Struktura e popullatës së shërbyer në bazë të rangut të largësive, indeksi i mbulueshmërisë me shërbime të MM	59
5.2 Struktura e popullatës së shërbyer në bazë të rangut të largësive, indeksi i mbulimit me shërbime të MM	59
5.3 Shpërndarja e gjenerimit të përlllogaritur të MM në bazë të largësive në kilometra prej pikës referente	60
6. Gjenerimi i mbeturinave të përlllogaritura	61
6.1 Raporti i shpërndarjes së mbeturinave në bazë të kategorive kryesore	61
6.2 Shpërndarja e mbeturinave në baze të largësive në KM - numri i banorëve x gjenerimi i mbeturinave në ditë.....	61
6.3 Sasia e mbeturinave të përlllogaritura në bazë të ofrimit të shërbimeve	61
6.4 Shpërndarja e gjenerimit të përlllogaritur të MM në bazë të largësive në kilometra prej pikës referuese	61
6.6 Struktura e mbeturinave të përlllogaritura për vitin 2014 e bazuar në zona (në ton)	62
6.7 Struktura e mbeturinave të përlllogaritura për vitin 2014 e bazuar në rangun e largësive të matura(në ton).....	62
7. Riciklimi	63
7.1 Projektimi i mundësisë së mbledhjes së mbeturinave për periudhën 2015-2012	63
7.2 Inputet për përlllogaritjen e riciklimit për periudhën 2016-2020	63
7.3 Riciklimi për periudhën 2016-2020 (në sasi)	63
7.4 Riciklimi për periudhën 2016-2020 (në EURO)	64
7.5 Përlllogaritja e të hyrave dhe kostove	64
7.6 Përlllogaritja e rikthimit të investimeve	64

PJESËMARRËSIT NË PROCESIN E PËRGATITJES NË PLANIN LOKAL TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE

Personat dhe Grupet e ndryshme që janë përfshirë në hartimin e PLMM-së për Komunën e Gjakovës

Grupi Punues:

1. **Fatos Deda** – Zyrtar në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mbrojtja e Mjedisit
2. **Burim Meqa** – Zyrtar në zyrën për Hartimin dhe Menaxhimin e Projekteve
3. **Afrim Ademi** – Zyrtar në Drejtorinë për Punë Inspektuese
4. **Hana Zeka** – Zyrtare në zyrën për Hartimin dhe Menaxhimin e Projekteve
5. **Selman Sahiti** – Zyrtar në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa
6. **Besim Shllaku** – Zyrtar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike
7. **Nehar Gërçari** – Zyrtar në Kompaninë Publike të Mbeturinave KRM” ÇABRATI”

Grupi Koordinues:

1. **Mimoza Kusari Lila** – Kryetare e Komunës së Gjakovës
2. **Shkumbin Kastrati** – Drejtorja për Shërbime Publike
3. **Mentor Sylmeta** – Drejtorja për Punë Inspektuese
4. **Teki Shala** – Drejtorja për Buxhet dhe Financa
5. **Bahri Bokshi** – Asambleist
6. Ekspertë Lokal - Demos/Recura

AKRONIMET / SHKURTESAT

PLMM	Plani Lokal i Menaxhimit të Mbeturinave
KRM	Kompania Regjionale e Mbeturinave
RAE	Komuniteti Romë Ashkali dhe Egjiptas
MM	Menaxhimi i Mbeturinave
KP	Kompania Publike
KK	Kuvendi Komunal
VSM	Vlerësimi Strategjik i Mjedisit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
NP	Ndërmarrja Publike
SMM	Spektori i Menaxhimit të Mbeturinave

Fjala hyrëse e Kryetares

“Krijimi i një sistemi për mirëmbajtjen e mjedisit të shëndoshë në Komunën e Gjakovës duke u bazuar në parimet dhe kornizën ligjore në fuqi të Republikës së Kosovës” është një ndër prioritetet e udhëheqjes së Komunës së Gjakovës.

Objektiva kryesore për arritjen e këtij vizioni është vendosja e një sistemi të qëndrueshëm të grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave. Për këtë arsye, krijimi i kushteve për implementim të plotë të Ligjit për Mbeturina është njëra ndër sfidat kryesore të Komunës.

Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave është një kërkesë ligjore, por edhe një dokument shumë i nevojshëm për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm me ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e mjedisit rrethues.

Falenderoj anëtarët e grupit punues dhe koordinues, organizatën HELVETAS Swiss Intercooperation/DEMOS si dhe të gjithë akterët tjerë për kontributin e dhënë në përpilimin e këtij dokumenti.

Singerisht,

Mimoza Kusari Lila,

Kryetare e Komunës së Gjakovës

Përmbledhje

Plani Lokal i Menaxhimit të Mbeturinave për Komunën e Gjakovës është dokument strategjik. Ky plan përcakton objektivat e Menaxhimit të Mbeturinave, të cilat janë në përputhje me strategjinë e Menaxhimit të Mbeturinave të Republikës së Kosovës. Plani Lokal është plotësisht në përputhje me të gjitha dokumentet dhe planet e miratuara në Komunën e Gjakovës.

Plani i Menaxhimit të Mbeturinave mbulon territorin e Komunës së Gjakovës, i trajton vetëm mbeturinat organike, komunale, të parrezikshme dhe si komponentë ka riciklimin e mbeturinave. Ky plan është në përputhje të plotë me Ligjin e Mbeturinave Nr.04/L - 060, dhe trajton bashkëpunimin me organet tjera përgjegjëse për ekonomi, financa, mbrojtjen e mjedisit, planifikimin urban, si dhe përfaqësuesit e kompanive apo kompanitë, shoqatat, institucionet profesionale, organizatat joqeveritare dhe të tjera, duke përfshirë edhe organizatat e vetë konsumatorëve.

Plani Lokal përfshin: llojin, sasinë dhe origjinën e të gjitha mbeturinave në territorin e Komunës, llojet e pritshme, sasinë dhe origjinën e mbeturinave të cilat do të përdoren ose hidhen në territorin e mbuluar nga Plani, objektivat që duhet të arrihen në aspektin e ri-përdorimit dhe riciklimin e mbeturinave në zonat e mbuluar nga plani, programi për zhvillimin e vetëdijes publike për menaxhimin e mbeturinave, vendndodhjen e objektit për grumbullimin e mbeturinave, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave, duke përfshirë edhe të dhënat për kushtet teknike urbanistike, masat për rehabilitimin e deponive të parregulluara, mbikëqyrjen dhe monitorimin e aktiviteteve të planifikuara dhe masave, vlerësimin e kostove të aktiviteteve të planifikuara, afatet për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të planifikuara, si dhe objektivat dhe masat me rëndësi për menaxhimin efikas të mbeturinave.

Sipas Ligjit për Mbeturina Nr.04/L-060, Komuna është përgjegjëse për hartimin e Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave dhe në kuadër të kornizës lokale ligjore, komuna ka miratuar: Planin Lokal të Veprimit në Mjedis, Rregulloren Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Rregulloren Komunale për Mbrojtjen e Mjedisit. Bazuar në regjistrimin e fundit të vitit 2011, Komuna e Gjakovës ka gjithsej 94.556 banorë. Duke iu referuar territorit dhe numrit të banorëve, Komuna e Gjakovës radhitet si Komuna e tretë në Kosovë për nga madhësia. Shtrirja e popullatës në Komunë është përafërsisht proporcionale në mes të zonës urbane dhe asaj rurale me 40.827 banorë në zonën urbane (43.2%) dhe 53.729 (56.8%) në zonat rurale. Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave aktualisht është 77.6% të popullatës së përgjithshme, dhe atë 100% në zonat urbane dhe rreth 60% në zonat rurale.

Sasia e mbeturinave e cila grumbullohet brenda një dite sillet nga 60-70 ton, përderisa indikacionet janë se sasia e gjithmbarshme e krijuar e mbeturinave është rreth 90 ton në ditë. Siç mund të vërehet nga konstatimi i mësipërm rreth 1/3 mbeturinave nuk arrihet të grumbullohet nga operatori aktual. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se sasia e mbeturinave mbetet e pa sistemuar, në të kundërtën, në territorin e Komunës operojnë disa operator të paregjistruar, të cilët në marrëveshje me përfaqësuesit e fshatrave kryejnë detyrat e operatorit primar të grumbullimit të mbeturinave. Fatkeqësisht një pjesë e konsiderueshme e mbeturinave hidhet në mënyrë të pa kontrolluar.

Prandaj, ky Plan ka cak vendosjen e sistemit të qëndrueshëm afatgjatë në menaxhimin e mbeturinave në nivel të Komunës.

Implementimi i planit për menaxhimin e mbeturinave 2015-2020 është i bazuar në dy faza: krijimin e një sistemi të shëndoshë të menaxhimit të mbeturinave (2015-2018/Faza e 1) dhe krijimi i sistemit të ri të grumbullimit dhe i menaxhimit të stacionit transfer (2018-2020 /Faza e 2).

Plan i Menaxhimit të Mbeturinave 2015-2020 parasheh:

- Mbulueshmërinë e territorit të Komunës së Gjakovës me ofrimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave 100%, arritjen e shkallës së grumbullimit 90%, zvogëlimin e shkallës së hedhjes ilegale në 10%, zvogëlimin e shkallës së deponimit final në 85%, rritjen e shkallës së riciklimit në 23%.
- Themelimin e sektorit të menaxhimit të mbeturinave brenda Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Zonimin e territorit të Komunës së Gjakovës, zonimi i territorit është bazuar në këto kriterë: shpërndarja proporcionale e zonave të drejtimeve dhe linjave të operimit në menaxhimin e mbeturinave, shpërndarja në bazë të numrit të banorëve, shpërndarja në bazë të numrit të amvisërive, shpërndarja në bazë të numrit të objekteve.
- Investimet financiare të ndodhin në bazë të nevojave afatshkurtër si dhe investimet kapitale për të përmbushur objektivat e përcaktuara nga Komuna Gjakovë.
 1. *Supozimet kryesore për investimet e nevojshme kapitale arrijnë shumën prej 1,600,600.00 euro.*
 2. *Sektori i Menaxhimit të Mbeturinave parashihet të ketë buxhet në shumën prej 28,000.00 euro.*
- Pilot projektet siç janë: shërbimi i grumbullimit të mbeturinave me përmasa të mëdha, minimizimi i mbeturinave përmes kompostimit, minimizimi i mbeturinave përmes ndarjes së mbeturinave nëpër shkolla, minimizimi i mbeturinave përmes qeseve të najlonit, riciklimi i mbeturinave përmes menaxhimit të mirëfilltë të Stacionit Transfer
- Planin e zbatimit të aktiviteteve

Si konkluzion, situata aktuale e menaxhimit të mbeturinave në Gjakovë është e tillë që Komuna e Gjakovës e ka të nevojshme që të fillojë të ndërtojë impiante të reja të asgjësimit dhe të rrisë buxhetin e menaxhimit të mbeturinave, si dhe të ndryshojë tarifat e pastrimit për të përmirësuar menaxhimin e mbeturinave në qytet. Përfituesit direkt nga zbatimi i këtij Plani Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave janë:

- Qytetarët të cilët do të jetojnë në një mjedis më të pastër, më të shëndetshëm dhe më të sigurt;
- Bizneset të cilët do të kenë rritje të aktiviteteve ekonomike, si rezultat i rritjes së numrit të turistëve të tërhequr nga qyteti i pastër dhe i mirë menaxhuar;
- Bizneset e riciklimit të cilët do të kenë qasje në sasi më të mëdha të materialeve të përdorura;
- Stafi i Komunës të cilët do të përfitojnë nga vizioni, qëllimet dhe objektivat e vendosura qartë si dhe plani i veprimit që do t'i drejtojë ata në 5 vitet e ardhshme për të përmirësuar shërbimet e tyre të menaxhimit të mbeturinave;
- Autoritetet Komunale të cilët do të përfitojnë nga rritja e reputacionit si rrjedhim i rritjes së numrit të qytetarëve më të kënaqur nga shërbimet e menaxhimit të mbeturinave;

1. Hyrje

1.1 Problematika e përgjithshme e mbeturinave në Kosovë

Mbeturinat e ngurta janë temë e vazhdueshme e ankesave nga qytetarët dhe mbetin prioritet për Komunitat në Kosovë. Një pjesë e madhe e mbeturinave vazhdon të hedhet në mënyrë të pakontrolluar. Për më tepër, sasia e mbeturinave është në rritje dhe Komunitat janë nën presion të konsiderueshëm që të ofrojnë shërbime më të mira për qytetarët në këtë fushë.

Vonesat në ndërmarrjen e masave të duhura mundësojnë që këto probleme të rriten edhe më tej duke rrezikuar shëndetin publik të qytetarëve të Komunitat.

Plani Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave (PLMM) 2015 - 2020 i Komunitat së Gjakovës është dokument i cili i vendos objektivat dhe rekomandon politika, programe dhe infrastrukturën e nevojshme për të menaxhuar mbeturinat në pajtim me prioritetet kombëtare dhe në një mënyrë që i plotëson nevojat e Komunitat së Gjakovës dhe qytetarëve të saj. Ligji për mbeturina i obligon Komunitat që të përgatisin Plan për menaxhimin e mbeturinave. Ky është plani i parë për menaxhimin e mbeturinave në Komunitatën e Gjakovës.

2. Historik i shkurtër i Komunitat

Komuna e Gjakovës shtrihet në zonën jug perëndimore të Kosovës në sipërfaqe prej 586 km². Sipas të dhënave kadastrale qyteti i Gjakovës përfshin një sipërfaqe prej 25km². Komuna kufizohet në jug me Republikën e Shqipërisë, në perëndim me territorin e Komunitat së Junikut, dhe Deçanit, në veri me Komunitatën e Pejës dhe Klinës, si dhe në lindje me Komunitat e Rahovecit dhe Prizrenit. Bjeshkët e Nemuna si dhe Mali i Pashtrikut dominojnë në zonën lindore dhe jugore të Komunitat, derisa Rrafshi i Dukagjinit shtrihet në pjesën dërmuese të Komunitat. Regjioni i Gjakovës ka pasuri të bollshme ujore ku më të mëdhenjtë janë pellgu i lumit Ereniku, pellgu i lumit Drini i Bardhë si dhe liqeni artificial i Radoniqit. Sipas Statutit, në Komunitatën e Gjakovës janë të evidentuara 91 vendbanime rurale.

2.1 Gjendja ekzistuese

Bazuar në regjistrimin e fundit të vitit 2011, Komuna e Gjakovës ka gjithsej 94.556 banorë. Duke iu referuar territorit dhe numrit të banorëve, Komuna e Gjakovës radhitet si Komuna e tretë në Kosovë për nga madhësia.

Shtrirja e popullatës në Komunitat është përafërsisht proporcionale në mes të zonës urbane dhe asaj rurale, me 40.827 banorë në zonën urbane (43.2%) dhe 53.729 (56.8%) në zonat rurale.


Tabela 1: Numri i popullsisë norma e rritjes për periudhën 2015-2020

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Numri i Popullatës	94,556	95,618	96,692	97,778	98,876	99,986
Norma e Rritjes	-	1,062	1,074	1,086	1,098	1,110

Burimi: ASK, 2011

Në bazë të vlerësimeve të bëra, në komunën e Gjakovës dominon mosha e re, dhe atë si në zonën urbane ashtu dhe atë rurale. Ndërsa grup mosha dominante e popullsisë janë kategoria 19-44 vjeçe.

Figura 1: Numri i popullsisë sipas grup moshave



Pjesa më e madhe e popullsisë në Komunën e Gjakovës është e koncentruar në reze nga 0 deri në 3km (43%). Nëse ky perimetër zgjerohet deri në 12 km distancë atëherë numri i popullsisë rritet në 85% të numrit të gjithmbarshëm të banorëve të Komunës.

Tabela 2: Tabela e shpërndarjes së popullsisë e bazuar në largësi dhe lokalitet

Popullata	0-3 km	3-6 km	6-9 km	9-12 km	12-20 km	Total	Ne %
Urbane	35,400	-	-	-	-	35,400	37.4%
Para Urbane	3,423	2,005	-	-	-	5,427	5.7%
Rurale	1,977	7,671	12,183	14,936	10,218	46,986	49.7%
Rurale e thellë	-	-	2,183	2,395	2,165	6,743	7.1%
Total	40,799	9,676	14,366	17,332	12,383	94,556	100.0%
Në %	43.1%	10.2%	15.2%	18.3%	13.1%		

2.2 Rolet dhe përgjegjësitë për menaxhimin e mbeturinave

Rolet dhe përgjegjësitë e organeve komunale në menaxhimin e mbeturinave janë paraqitur në kutinë më poshtë:

- Drejtoria e Shërbimeve Publike (DShP) është përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha punimeve në pronën publike dhe komunale, monitorimin e punëve të kompanive të angazhuara për mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve dhe hapësirave tjera komunale.
- Drejtoria e Financave është përgjegjëse për caktimin e tarifave të shërbimit dhe mënyrën e vjeljes së mjeteve.
- Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, e cila ndër të tjera është përgjegjëse për planifikimin e zhvillimit hapësinor dhe urbanistik të Komunës, ndihmon në përgatitjen e rregullores lokale për kontroll të mbeturinave dhe hedhurinave brenda territorit të Komunës, po ashtu siguron mbështetje në zhvillimin e projekteve në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit.
- Drejtoria për Punë Inspektuese e cila është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe dispozitave të rregulloreve komunale në lëmin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Mjedisit, Bujqësisë dhe Pyltlarisë.
- Komisioni komunal i aksionarëve për Ndërmarrjen “Çabрати” është organi përgjegjës për mbikëqyrjen e punës së ndërmarrjes, dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për të avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

2.3 Operatori i menaxhimit të mbeturinave

Operatori i vetëm i autorizuar nga Komuna e Gjakovës momentalisht është KRM “Çabрати” e cila është 100% në pronësi të Komunës. Veprimtaria primare e operatorit publik është grumbullimi dhe transporti i mbeturinave komunale, si dhe shërbime dytësore si: menaxhimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike, pastrimin e rrugëve, pastrimin e borës, si dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara publike dhe varrezave.

Kompania shërben tri kategori të konsumatorëve, respektivisht konsumatorët e ekonomive familjare, bizneset dhe institucionet. Konsumatorët e ekonomive familjare ndahen sipas mënyrës se si e pranojnë shërbimin, në konsumatorë e ekonomive familjare të cilët pranojnë shërbimin derë më derë dhe konsumatorë të pajisur me kontejnerë. Bizneset ndahen në biznese të vogla dhe të mesme të cilat pranojnë shërbimin pa kontrata dhe bizneset të mëdha me kontrata të veçanta të shërbimit. Bizneset e vogla dhe të mesme një pjesë e tyre shërbehet me shërbimin derë më derë dhe pjesa tjetër është e pajisur me kontejnerë të veçantë. Bizneset me kontrata janë të pajisura me kontejnerë të veçantë. Institucionet janë kategori e tretë e konsumatorëve, ndonjë zyre të vogël të OJQ-ve, avokatie apo të ngjashme zakonisht janë me kontrata të veçanta dhe të shërbyer me kontejnerë të veçantë.

Periodha kohore e grumbullimit të mbeturinave zakonisht zhvillohet nga ora 08:00 – 14:30. Në raste të veçanta ndodhë bartja edhe pas këtij orari por jo më vonë se ora 18:00.

Procedurën dhe metodologjinë e caktimit të tarifave, momentalisht kompania është duke e aplikuar sipas modelit të ZRRUM-it, të ndryshuara dhe aprovuara nga Bordi i Drejtorëve në Qershor të vitit 2012, të cilat ende janë në fuqi. Mekanizmi i vjeljes për momentin në amvisëri dhe biznese të vogla bëhet përmes inkasantëve dhe arkës ndihmëse, por ka raste që bëhet edhe nëpërmjet llogarisë rrjedhëse nga konsumatori. Kurse tek bizneset e mëdha dhe institucionet, vjelja bëhet përmes arkës dhe llogarive rrjedhëse.

Numri total i klientëve të kompanisë “Çabрати” për vitin 2014 ka qenë gjithsej 11,642 prej të cilëve:

- konsumatorë ekonomikë familjare janë 9,559,
- biznese të vogla 1,975,
- biznese të mëdha 64 dhe
- institucione publike 44.

Arkëtimi për këto kategori në vitin 2014 ka qenë:

- ekonomik familjare 69.47%;
- biznese të vogla 51.32%;
- biznese të mëdha 81.05%;
- institucione 100.00%.

Shtrirja zonale e familjeve dhe bizneseve të cilat janë të përfshira në shërbimin e menaxhimit të mbeturinave sipas kompanisë “Çabрати” është:

- **Zona Urbane:** është – 8,288 familje
- **Zona Rurale**
 1. Zona e Hasit – 477 familje
 2. zona e Rrekës Keqe – 362 familje
 3. zona Dushkajës – 432 familje

Kompania “Çabрати” ka të punësuar gjithsej 133 punonjës, prej të cilëve 56 janë të angazhuar si personel direkt dhe 41 si personel indirekt në ofrimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave. Kompania ofron edhe një gamë të gjerë të shërbimeve komunale ku janë të angazhuar 36 të punësuar.

Stacioni transferues i mbeturinave menaxhohet nga kompania dhe ka tre të punësuar (një vozitës kamioni dhe dy punëtorë). Mbeturinat e mbledhura nga konsumatorët grumbullohen në Stacionin transferues ku nga aty ringarkohen në kontejnerë të mëdhenj (25-28 ton) dhe përfundimisht shpërkohen në deponinë sanitare në Landovicë që menaxhohet nga Kompania për Menaxhimin e Mbeturinave të Kosovës (KMDK) – Prishtinë. Pagesa/taksa e deponimit permanent bëhet tek Deponia Sanitare në Landovicë, ku edhe bëhet matja përkatëse.

Kapaciteti ruajtës i mbeturinave me kontejnerët ekzistues është 548 m³ respektivisht 55-81 ton. Sa i përket infrastrukturës grumbulluese, bartëse dhe transportuese të kompanisë përbëhet nga kamionë kompaktorë, rrotullues dhe vetëngarkues përmes të cilëve bëhet grumbullimi i mbeturinave dhe bartja e tyre deri tek stacioni i transferit. Kompania zotëron me 3 kamion kompaktorë me kapacitet bartës 21 ton, 5 kamion kompaktorë me kapacitet 25 ton, 3 kamion vetëngarkues me kapacitet 3 tonë si dhe me kamionin me rimorkio me kapacitet 28 ton i cili përdoret për transferimin e mbeturinave deri te deponia.

2.4 Menaxhimi i Mbeturinave

Sasia e mbeturinave e cila grumbullohet brenda një dite sillet 60-70 ton, përderisa indikacionet janë se sasia gjithmbarshme e krijuar e mbeturinave është rreth 90 ton në ditë. Siç mund të vërehet nga konstatimi i mësipërm rreth 1/3 mbeturinave nuk arrihet të grumbullohet nga operatori aktual. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se sasia e mbeturinave mbetet e pa sistemuar, në të kundërtën, në territorin e Komunës operojnë disa operator të paregjistruar të cilët në marrëveshje me përfaqësuesit e fshatrave kryejnë detyrat e operatorit primar të grumbullimit të mbeturinave. Për fat të keq një pjesë e konsiderueshme e mbeturinave hidhet në mënyrë të pa kontrolluar.

Arsyet kryesore për grumbullimin jo të plotë të mbeturinave janë të ndryshme, si:

- Niveli i ulët i vetëdijes në mesin e banorëve;
- Kapacitetet e kufizuara të Ndërmarrjes Publike për menaxhimin e mbeturinave;
- Mos pagesa e një pjese të përfituesve të shërbimit;
- Mos zgjidhja e çështjes së mbeturinave ndërtimore (demolimeve);
- Problemi i pazgjidhur i menaxhimit të mbeturinave nga mbetjet shtazore;
- Shkalla e ulët dhe informale e klasifikimit dhe riciklimit.

Aktualisht operatori i vetëm, i licencuar nga komuna, është NP “Çabrat” e cila sipas shënimeve ofron shërbim primar të grumbullimit të mbeturinave për 77.6% të popullatës së përgjithshme, dhe atë 100% të zonës urbane dhe rreth 60% në zonat rurale.

Me gjithë përparimet e shënuara, disa kategori të mbeturinave paraqesin një sfida jo të lehtë për komunën, në veçanti mbeturinat ndërtimore/demolimet, mbeturinat shtazore, etj.

Mbeturinat nga konstruktiv/demolimet:

Si rezultat i mosekzistimit të deponisë adekuate për këtë kategori të mbeturinave, mbeturinat nga materialet ndërtimore dhe demolimet hidhen gjithandej duke renduar aspektet mjedisore dhe estetike. Shpesh hedhja e pakontrolluar e këtyre mbeturinave shkakton krijimin e deponive të egra dhe hedhjen e mbeturinave të ndryshme nga ana e banorëve dhe bizneseve. Përpos kësaj nuk ekziston lidhja në mes të dhënies së lejeve ndërtimore dhe sistemit të monitorimit të hedhjes së mbeturinave. Sa i përket deponisë së inerteve Komuna është në procesin e përzgjedhjes së lokacionit të duhur. Projekti i ndërtimit të deponisë së inerteve është i përfshirë në listën e projekteve që parashihen të realizohen në Planin e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave, ku parashihet bashkëfinancimi 40% donatori; 30% Buxheti i Kosovës; dhe 30% Komuna e Gjakovës.

Mbeturinat nga Mbetjet Shtazore:

Menaxhimi i mbetjeve shtazore në Komunën e Gjakovës nuk është në harmoni me dispozitat në fuqi, në rend të parë për shkak të mungesës së impiantit të trajtimit të mbetjeve shtazore. Në Komunë ekzistojnë 18 subjekte që merren me prodhimin, përpunimin dhe konservimin e mishit, si dhe 33 syresh që merren me tregtimin e mishit dhe produkteve të mishit. Me disa prej tyre operatori aktual ka kontrata të shërbimit dhe i grumbullon mbeturinat, ndërsa një pjesë e subjekteve i hedh këto mbeturina në formë ilegale. Për më shumë, edhe mbeturinat me prejardhje shtazorë që grumbullohen nga ana e operatorit të licencuar, nuk është e qartë si trajtohen meqë deponia regjionale nuk pranon që ky lloj i mbeturinave të deponohet në këto lokacione të veçanta.

Strategjia dhe Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave, parashohin financimin e ndërtimit të impiantit të mbetjeve shtazore, i cili do të parashihte rregullimin e menaxhimit të mbeturinave të kësaj natyre në nivel të Kosovës përfshi këtu edhe Komunën e Gjakovës. Realizimi i këtyre projekteve që parashihet të realizohen në periudhën projektuese do të kontribuonte në menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave komunale.

2.5 Sfidat në menaxhimin e mbeturinave të cilat nuk janë në kompetencë të drejtpërdrejt të Komunës

Përveç mbeturinave të zakonshme të ekonomive familjare dhe bizneseve të cilat janë në kuadër të kompetencave të Komunës, ekziston edhe një kategori e konsiderueshme e mbeturinave të cilat deponohen në territorin e Komunës dhe që nuk janë kompetencë e drejtpërdrejtë e saj.

Mbeturinat Kimike-Industriale:

Komuna e Gjakovës ka në territorin e saj të identifikuar disa “deponi” me mbeturina kimike-industriale me sasinë e deponuar që tejkalojnë 5 ton për deponi. Lokacionet ku ndodhen këto mbeturina përfshijnë:

- New Co Jatex (ish Ndërmarrja JATEX), mbeturina me origjinë nga prodhimi i tekstilit,
- New Co Miniera Devë, mbeturina me origjinë minerare,
- Metaliku, mbeturina me origjinë nga procesimi i metaleve, dhe
- New Co Emin Duraku -Devolli, mbeturina me origjinë nga procesimi i tekstilit.

Përkundër faktit se Ligji mbi Mbeturinat dhe Udhëzimi Administrativ përkatës për Kompetencat e Zotëruesit të Mbeturinave, precizon obligimet e akterëve mbi menaxhimin e mbeturinave industriale dhe kimike, megjithatë këto vend-deponi të mbeturinave në mënyrën si trajtohen paraqesin rrezik për mjedisin përreth dhe shëndetin publik. Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2012-2021, në kaptinën investive të menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme, përfshinë ndër projektet me prioritet për pastrimin e mbeturinave nga procesimi i tekstilit të ish kombinatit Emin Duraku dhe ndërmarrjen JATEX.

Mbeturinat Medicinale:

Në komunën e Gjakovës respektivisht në spitalin rajonal është i instaluar impianti për trajtimin e mbetjeve medicinale me kapacitet të trajtimit 1,500-1,800 kg/ditë i cili në rrethana normale do të mjaftonte për menaxhimin e të gjitha mbeturinave medicinale. Megjithatë për shkak të mos menaxhimit të duhur të impiantit dhe problemeve teknike ai punon me kapacitet simbolik (10 kg/ditë) apo edhe me ndërprerje të plotë. Për rrjedhojë mbeturinat medicinale me përmbajtje të lartë toksike siç janë: mbetjet nga kulturat biologjike, mbetjet anatomike dhe materialet nga intervenimet kirurgjike, gjaku, shiringat e përdorura, etj përfundojnë në kontejnerë komunal duke kontaminuar të gjitha mbeturinat e ngurta komunale. Në këtë mënyrë garantohet konsistenca në qëndrimet e grupit dhe transparenca në punën e tij.

2.6 Korniza kombëtare ligjore dhe politikat

Menaxhimi i mbeturinave në Republikën e Kosovës rregullohet përmes Kornizës Ligjore e cila është e harmonizuar me legjislacionin evropian, respektivisht direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian të cilat rregullojnë sektorin e mbeturinave. Qëllimi kryesor i kornizës ligjore për menaxhimin e mbeturinave është evitimi dhe reduktimi në masë sa më të madhe të mundshme të gjenerimit të mbeturinave, ripërdorimi i komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat, parandalimi i ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut si dhe deponimi përfundimtar i mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore.

Korniza ligjore përbëhet prej ligjeve dhe akteve nënligjore të cilat rregullojnë menaxhimin e mbeturinave. Ligji kryesor i cili në mënyrë të detajuar rregullon menaxhimin e mbeturinave është Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina. Ky ligj përcakton dhe rregullon planifikimin dhe menaxhimin e mbeturinave; kushtet për grumbullimin e mbeturinave, transportin, trajtimin, magazinimin dhe asgjësimin, llojet dhe klasifikimin e mbeturinave, përgjegjësitë e personave juridik dhe fizik lidhur me menaxhimin e mbeturinave, kushtet dhe procedurat e licencave dhe lejeve për menaxhimin e mbeturinave, ndëshkimet për mosrespektimin e dispozitave ligjore si dhe çështjet tjera lidhur me mbeturinat. Neni 14 dhe 15 i Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, përcakton përgjegjësit për menaxhimin e mbeturinave të institucioneve të nivelit qendror dhe nivelit lokal. Me Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina, komuna merr përgjegjësi shtesë lidhur me menaxhimin dhe administrimin e mbeturinave.

Përveç ligjeve të lartpërmendura, Korniza Ligjore për menaxhimin e mbeturinave përmban edhe një numër të konsideruar të ligjeve tjera dhe sektoriale të cilat në mënyrë indirekte rregullojnë menaxhimin e mbeturinave, siç janë: Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, etj.

Neni 17 i Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, përcakton menaxhimin e mbeturinave si kompetencë të plotë dhe ekskluzive të komunave. Në bazë kësaj kompetence Komunitat kanë autorizim ligjor të krijojnë struktura, mekanizma si dhe të parashohin buxhet të veçantë me qëllim të menaxhimit sa më të mirë dhe efikas të sektorit të mbeturinave.

Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike përcakton dhe rregullon pronësinë e ndërmarrjeve publike për menaxhimin e mbeturinave, udhëheqjen kooperative të tyre në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare. Neni 6 i Ligji Nr. 04/L-111 për Ndërmarrjet Publike mundëson krijimin e ndërmarrjeve publike lokale nga komunitat. Ndërsa me nenet 4, 5, dhe 6 të Rregullores Nr.02/2013 përcaktohen kriteret dhe procedurat për krijimin e ndërmarrjeve publike për menaxhimin e mbeturinave. Në bazë të nenit 5.2 të këtij ligji të drejtën e komunës si aksionar e ushtron Komisioni Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga: një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Komisioni Komunal i Aksionarëve vepron në emër të Komunës në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare.

2.6.1 Korniza lokale ligjore

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina, Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike si dhe ligjet tjera sektoriale, komuna është e obliguara të krijoj kornizën lokale ligjore me qëllim të menaxhimit sa më efikas të mbeturinave në territorin e tyre. Kornizat lokale përbëhen nga rregulloret komunale, udhëzimet, politikat, rregullatorë të ndryshëm, dhe vendimet që rregullojnë sektorin e menaxhimit të mbeturinave.

Në kuadër të kornizës lokale ligjore, komuna ka miratuar: Planin Lokal të Veprimit në Mjedis, Rregulloren Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave në Territorin e Komunës së Gjakovës dhe Rregulloren Komunale për Mbrojtjen e Mjedisit.

3. Planifikimi i Menaxhimit të Mbeturinave

3.1 Fushëveprimi i planit

Plani Lokal për Menaxhim të Mbeturinave paraqet dokument me të cilin organizohet procesi i menaxhimit të mbeturinave në nivel të Komunës. Në të cilin do të definohen drejtimitet dhe prioritetet, si dhe dinamika dhe mënyra e zgjidhjes së problemeve në harmoni me legjislaturën pozitive kombëtare dhe të BE-së në aspektin e menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi. PLMM përveç se është detyrim ligjor, ka për synim gjetjen dhe zbatimin e alternativave më të mira për menaxhim të mbeturinave.

Synimi i punimit të Planit është vendosja e sistemit të qëndrueshëm afatgjatë në menaxhimin e mbeturinave në nivel të Komunës, në mënyrë që të përmirësoj cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor. Shfrytëzimin racional të burimeve dhe respektimin e parimeve moderne në menaxhimin e mbeturinave, me pjesëmarrje të koordinuar të të gjitha akteve të menaxhimit të mbeturinave.

Në kuadër të PLMM do të bëhet analiza e kapaciteteve ekzistuese për trajtimin e mbeturinave, po ashtu do të bëhet analiza e kapaciteteve ekzistuese të menaxhimit të mbeturinave, në bazë të cilave do të shqyrtohet nevoja për zhvillime të mëtutjeshme. Synim tjetër i rëndësishme i PLMM është që të adresoj shumë çështje të hapura të cilat determinojnë vendosjen e një sistemi tërësisht të ri në menaxhim të mbeturinave, i cili bazohet në kahjet që jep Strategjia Kombëtare për Menaxhim të Mbeturinave të Republikës së Kosovës, Ligji për Mbeturina, Standardet Evropiane dhe masat ligjore që prekin këtë lami.

3.2 Synimet e përgjithshme PLMM-së

PLMM-ja paraqet dokumentin bazë me të cilin organizohet procesi i menaxhimit të mbeturinave në nivel të Komunës. Komuna e Gjakovës është e përcaktuar që të përmirësoj gjendjen e menaxhimit të mbeturinave dhe në këtë drejtim ka parashtruar objektiva specifik që janë pjesë integrale e këtij plani. Ato përfshijnë shtrirjen e shërbimeve, parandalimin, minimizimin dhe riciklimin e mbeturinave si dhe eliminimin e hedhjes së mbeturinave në hotspote, por në vendin e përcaktuar. Objektivat janë të ndarë në dy etapa respektivisht në periudhën 2015-2018 dhe 2018-2020.

Komuna synon që përmes planit të menaxhimit të mbeturinave të arrijë:

- Qytet të pastër, mjedise të shëndetshme për qytetarët,
- Zbatimin e koncepteve të menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane,
- Promovimin dhe mbështetjen e aktiviteteve të përpunimit të mbeturinave,
- Mbulimin me shërbim të tërë zonës përmes tarifës së përballueshme,
- Të definojnë synimet e menaxhimit të mbeturinave në nivel komunal në harmoni me legjislaturën kombëtare,
- Të definojë sistemi optimal i menaxhimit të mbeturinave,
- Të definojnë investimet e përgjithshme financiare dhe investimet në pjesët prioritare të planit të cilat duhet menjëherë të zbatohen.

Objektivat:


1. Vendosja e sistemit institucional për menaxhim me mbeturina,
2. Vendosja e sistemit të taksave, tarifave dhe vjeljes së mjeteve,
3. Mbulueshmëria e tërë territorit me shërbim të grumbullimit të mbeturinave
4. Shndërrimi i stacionit transferues të mbeturinave në qendër të ndarjes së mbeturinave me qëllim profiti përmes investimeve kapitale – private,
5. Eliminimi i të gjitha deponive ilegale të mbeturinave,
6. Zhvillimin e pilot projekteve me qëllim të realizimit të 3R-konceptit (reduktim, ripërdorim dhe riciklim).

Synimet:

Plani synon të menaxhoi me mbeturinat nga ekonomitë familjare (amvisëritë dhe nga bizneset afariste), dhe mbeturinat komunale.

- Shkalla e mbulueshmërisë së shërbimit të grumbullimit do të thotë shkalla e popullsisë së shërbyer me popullsinë e përgjithshme.
- Shkalla e grumbullimit do të thotë shkalla e sasisë së mbeturinave të grumbulluara me sasinë e përgjithshme të gjeneruara.
- Shkalla e hedhjes ilegale do të thotë shkalla e mbeturinave të hedhura ilegalisht duke përfshirë hedhjen jo të duhur brenda zonës pa shërbim me sasinë e përgjithshme të mbeturinave të gjeneruara.
- Shkalla e deponimit final do të thotë shkalla e mbeturinave të deponuara në deponitë e licencuara dhe ato të pa licencuara (hedhja ilegale) me sasinë e përgjithshme të mbeturinave të gjeneruara.
- Shkalla e riciklimit do të thotë sasia e mbeturinave të ricikluara me sasinë e përgjithshme të gjeneruara.

Figura 2: Synimet e PLMM-s të shprehur në % gjatë periudhës 2015-2020



3.3 Fazat e zbatimit të planit 2015-2020

Vizioni i lartpërmendur do të arrihet hap pas hapi. Viti i synuar i Planit për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Gjakovës, është prej 2015 deri 2020. Kjo periudhë ndahet në dy faza, si më poshtë.

Implementimi i planit për menaxhimin e mbeturinave 2015-2020 është i bazuar në dy faza:

- **Faza e parë (2015 – 2018)** - Krijimi i një sistemi të shëndoshë të menaxhimit të mbeturinave, që nënkupton se brenda kësaj periudhe kohore do të krijohet sektori i menaxhimit të mbeturinave, në mënyrë që të krijohet data baza e të dhënave, e cila do të shërbente për një menaxhim efikas rreth mbeturinave dhe po ashtu mundësia që të realizohet vjelja për mbeturina në Komunë. Në vitin 2017 do të synohet qëllimi ligjor i krijimit të kushteve që vjelja e hyrave të kalojë në Komunë, implementimi i plotë i vjeljes synohet të përfundojë në vitin 2018.
- **Faza e dytë (2018 – 2020)** - Krijimi i sistemit të ri të grumbullimit dhe i menaxhimit të stacionit transferues, që nënkupton se gjatë kësaj periudhe synohet të arrihet sistemi i ri i grumbullimit të mbeturinave për arsye se do të mbulohet i gjithë territori administrativ i Komunës me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave, si dhe synohet të arrihet kontraktimi i operatorit privat për menaxhimin e stacionit transferues.

Duke u bazuar në synimet e ndara në këto dy faza, plani pesë vjeçar i MM-së mund të **modifikohet deri në fund të vitit 2017**, bazuar në progresin e performancës aktuale në fazën e parë. Realizimi i planit në periudhën e planifikuar do të modifikohet, monitorohet e të përshtatet në fund të vitit 2017 bazuar në arritjet e rezultateve të përcaktuara në fazën e parë.

3.3.1 Plotësimi i kornizës lokale ligjore

Më qëllim të plotësimit të kornizës lokale ligjore dhe përmirësimit të saj në aspektin e menaxhimit të mbeturinave, duhet të hartohen dhe miratohen Rregulloret e mëtutjeshme lidhur me skemën organizative me strukturë dhe përmasë të shërbimit për grumbullimin dhe ndarjen e mbeturinave për çdo vendbanim, lagje apo hapësirë ose sipërfaqe publike, orarin dhe dinamikën e mbledhjes së mbeturinave, mënyrën dhe skemën e organizimit të vlerës së vjeljes dhe mënyrës së vjeljes, etj.

3.4 Themelimi i sektorit të Menaxhimit të Mbeturinave

Për të realizuar planin për MM, Komuna e Gjakovës fuqizon Sektorin e Menaxhimit të Mbeturinave të themeluar brenda Drejtorisë së Shërbimeve Publike e cila do 'i ketë këto përgjegjësi:

- Do të bëjë në bashkëpunim me akterët gjegjës implementimin e planit për menaxhim të mbeturinave,
- Do të përpiloj në bashkëpunim me akterët gjegjës planet operative për grumbullimin dhe trajtim të mbeturinave, duke i caktuar zonat e operimit,
- Do të përpiloj në bashkëpunim me akterët gjegjës planin për vjeljen e mjeteve financiare,
- Në bashkëpunim me akterët gjegjës, do të caktoj kushtet dhe kriteret speciale për operatorët që do të merren me grumbullim, transportim dhe trajtim të mbeturinave si dhe do të organizoj monitorimin dhe vlerësimin e këtyre kompanive,
- Në bashkëpunim me akterët gjegjës të zhvilloj procedura dhe aktivitete për monitorim të aktiviteteve që zvogëlojnë sasinë e hedhjeve ilegale, të zhvilloj dhe menaxhoj planet për eliminim të pikave me mbeturina ilegale,
- Në bashkëpunim me akterët gjegjës të zhvilloj pilot projekte që kanë për qëllim përmirësimin e performancës së Komunës në lëmin e menaxhimit të mbeturinave,
- Në periudhën afatshkurtër, në vitin 2016 Komuna, përmes thirrjeve publike do të kontrakttoj operatorët për grumbullim dhe trajtim të mbeturinave me të drejtë të vjeljes së tarifës së shërbimit.

3.5 Zonat e shërbimit

Zoonimi i territorit të Komunës së Gjakovës për qëllime të menaxhimit të mbeturinave:

Për qëllime të organizimit të menaxhimit të mbeturinave është krijuar sistemi i zoonimit të territorit.

Zonimi i territorit është bazuar në kriteret:


- Shpërndarja proporcionale e zonave të drejtimeve dhe linjave të operimit të menaxhimit të mbeturinave
- Shpërndarja në bazë të numrit të banorëve
- Shpërndarja në bazë të numrit të ekonomive familjare
- Shpërndarja në bazë të numrit të objekteve

Zona e synuar për Planin Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave është e gjithë zona administrative e Komunës së Gjakovës. Zonat që synohen të arrihen me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave në kuadër të Planit Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave janë të ndara si më poshtë:

Tabela 3: Zonimi i territorit me qëllim të ofrimit të shërbimit për grumbullimin e mbeturinave

Nr.	Zona	Nr. i lokalit.	Popullata	Sipërfaqja m ²	Ekon. Familjare	Nr. Objekteve
1	Zona 1	4	38,822	38,390,560	8,413	19,212
2	Zona 2	19	14,202	203,633,213	1,172	2,816
3	Zona 3	22	19,266	149,829,260	2,040	4,628
4	Zona 4	21	22,265	169,321,554	2,726	5,485
Total		66	94,556	561,174,587	14,351	32,141

Figura 3: Harta e Komunës së Gjakovës e ndarë në 4 zona për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave



3.6 Krijimi i sistemit financiar për menaxhimin e mbeturinave

Në mënyrë që pritjet të jenë të kënaqshme për të hyrat nga taksa dhe tarifat për mbeturina që është planifikuar të prezantohet nga fundi i viti 2016, është shumë i rëndësishëm themelimi i një sistemi të mirëfillt të menaxhimit të mbeturinave, për këtë arsye Komuna e Gjakovës duhet të bëjë aktivitetet e planifikimeve buxhetore. Këto planifikime do të përfshijnë formimin e vijës buxhetore për realizimin e të hyrave nga taksa dhe tarifa e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, si dhe vijat buxhetore për realizimin e kontraktimit të shërbimit për menaxhim të mbeturinave. Në anën tjetër, menaxhimi i taksës së grumbulluar është shumë i rëndësishëm edhe me këtë do të krijohej një sistem financiar i operuar lehtësisht në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave. Për krijimin e një sistemi financiar duhet që Komuna të pajiset me softuerë i cili do të jetë në kuadër të Shërbimeve Publike, por i ndërlidhur edhe me Drejtorinë e Financave.

Deri në implementimin e plotë të ligjeve në fuqi në periudhën afatshkurtër – gjatë vitit 2016, Komuna përmes thirrjeve publike duhet të kontrakttoi operatorët për grumbullim dhe trajtim të mbeturinave me të drejtë vjeljes së tarifës së shërbimit në zonat e paracaktuara për aktivitet të grumbullimit për periudhën afatshkurtër që është sipas zonave të paraqitur në figurën 3.

3.7 Përmirësimi i sistemit të grumbullimit të mbeturinave

Komuna e Gjakovës brenda periudhës 2016-2020 do të menaxhoi me mbeturinat komunale duke u bazuar në Ligjin mbi Mbeturinat, prandaj gjatë kësaj periudhe Komuna e Gjakovës do të siguroi buxhetin e nevojshëm përmes taksës për mbeturina, e cila do të mbliidhet nga qytetarët dhe bizneset e vogla të cilat shkarkojnë mbeturinat e tyre bashkë me mbeturinat e ekonomive familjare dhe në mënyrë të drejtë do t'ua besojë këtë kompanive për grumbullim dhe transportim të mbeturinave komunale, të licencuara nga MMPH-ja.

Komuna e Gjakovës do të shfuqizon sistemin aktual të grumbullimit të mbeturinave, duke bërë një planifikim që kompanitë/operatorët të bëjnë kontraktimin në bazë të zonave, në mënyrë që i gjithë territori i Komunës të mbulohet me shërbimet e grumbullimit të mbeturinave duke përfshirë edhe pastrimin e rrugëve dhe mirëmbajtjen e gjelbërimit.

Përmes investimeve kapitale private, Komuna e Gjakovës planifikon që hapësirën e stacionit transit të mbeturinave ta shndërroj në qendër për ndarje të materialeve me qëllim riciklimi.

Trajtimi i mbeturinave nga konstruktiv – demolimi:

Sipas udhëzimit administrativ MMPH-Nr.07/2015 për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, neni 13 thotë që: Komunitat brenda territorit të tyre caktojnë qendrat për grumbullimin, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtim/demolimi, ku Komuna e Gjakovës është në fazën e caktimit të lokacionit për mbeturinat nga konstruktiv/demolimi sipas kritereve ligjore, ku planifikohet që këto mbeturina të grumbullohen, të largohen nga të gjitha hapësirat publike dhe nga shtrati i lumenjve dhe pastaj gjatë kësaj periudhe Komuna do ti trajtoi me qëllim të përfitimit të materialeve të riciklueshme.

4. Plani Financiar 2015-2020

Për hartimin e planit financiar 2015-2020 janë shfrytëzuar burimet e informacionit të Operatorit aktual si dhe informatat financiare me 31.12.2014.

Projektimi i të hyrave është i bazuar në strukturën e hyrave të vitit 2014 me një indeks rritje konservator, si dhe zvogëlimit të kostove të bazuar në investimet e planifikuara.

Shkalla e mbulimit me shërbimet e MM në Komunë është 78%, e shprehur në numër të popullatës 73,331, lokalitetet e mbuluara numërojnë 30 lokalitete.

Sipërfaqja e mbuluar me shërbime të MM është 268.147 Km² e shprehur në përqindje 48% prej totalit të sipërfaqeve të 561.175 Km². Objektivi i KK Gjakovë deri në përmbyllje të periudhës planifikuese 2015-2020, të mbulohet i tërë territori me shërbime të MM, e cila nënkupton mbulimin me shërbime të MM 2,340 ekonomi familjare, 36 lokalitete si dhe popullatën prej 21,225 persona.

4.1 Supozimet kryesore në planin financiar

Për krijimin e planit financiar të Menaxhimit të Mbeturinave janë të nevojshme disa supozime të bazuara në gjendjet e vështuara në sektorin e menaxhimit të mbeturinave si dhe në rezultatet financiare të vitit 2014 të Operatorit aktual.

Supozimet janë të bazuara në objektivat e KK Gjakovë për ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarë dhe biznese duke mos marrë në konsideratë format e reja të mundshme të pjesëmarrësve të tjerë të operatorëve ekonomik në menaxhimin e mbeturinave.

Supozimet kryesoret të planit financiar janë:

- Operatori aktual për vitet afariste 2013 e 2014 ka afarizëm pozitiv,
- Investimet do të ndodhin në bazë të nevojave afatshkurtër si dhe investimet kapitale për të përmbushur objektivat e përcaktuara nga Komuna Gjakovës.
- Investimet e nevojshme në sektorin e MM do të jenë intensive në dy vitet e para të planit të (2015-2016) të mundësoi përmirësimin të menjëhershëm të nivelit të cilësisë së shërbimit të MM.
- Kostot e menaxhimit të mbeturinave do të reduktohen si rezultat i investimeve të reja, modernizimit të mjeteve, si dhe qasjes bashkëkohore në fushën e menaxhimit të mbeturinave.
- Norma e arkëtimit planifikohet të shënoj rritje në të gjitha kategoritë e klientëve (ekonomitë familjare, bizneset e vogla, bizneset e mëdha e institucionet) në norma të arsyeshme për periudhën e planifikuar.
- Shkalla e mbledhjes së mbeturinave të gjeneruara pritet të shënoj rritje përgjatë periudhës së planifikimit
- Numri i klientëve (ekonomitë familjare e bizneset) të cilët aktualisht nuk janë të përfshira në sistemin e menaxhimit të mbeturinave, planifikohet përfshirja e tërësishme e tyre për periudhën e planifikimit 2015-2020.
- Mbulimi i tërësishëm i zonës me shërbime të menaxhimit të mbeturinave për periudhën e planifikimit 2015-2020. Pjesa e **pa mbuluar** aktuale me shërbimet e MM-së përbehet prej 21.225 banor, 2340 ekonomi familjare dhe 36 lokalitet. Procesi i mbulimit të tërësishëm përfundon në vitin 2020.

Tabela 4: Shënimet e përgjithshme të zonës, popullatës e gjenerimi i mbeturinave

Popullsia (rezidente/sipas regjistrimit të popullsisë)	94,556				
Popullsia - kategorizimi (rezidente/sipas regjistrimit të popullsisë)	Total	Ne %	E mbuluar	Jo -Mbuluar	% Mbulimi
Urbane	35,400	37.4%	35,400	-	100%
Para Urbanë	5,427	5.7%	5,427	-	100%
Rurale	46,986	49.7%	31,419	15,567	67%
Rurale - Thelle	6,743	7.1%	1,085	5,658	16%
Popullsia (rezidente/sipas regjistrimit të popullsisë)	94,556	100.0%	73,331	21,225	78%
% e popullsisë që përfshihen	22%		77.6%	22.4%	
Popullsia shërbyer (merr/konsiderohet për shërbimin)	73,331				
Numri i popullsisë të mbuluar me shërbime MM	77.6%				
Numri i popullsisë-të pambuluar me shërbime	22.4%				

Të - mbuluara					
Kategoria	Vendi	Popullata	Ekon. Familj.	Sipërfaqja Km ²	Distanca ne KM(Mesatare)
Urbane	2	35,400	8,326	25,455	1.4
Rurale	24	31,419	2,981	202,274	8.0
Para - Urbane	3	5,427	617	18,475	2.5
Rurale - Thelle	1	1,085	87	21,943	8.2
Total: Të - mbuluara	30	73,331	12,011	268,147	7.0
Pa - mbuluara					
Kategoria	Vendi	Popullata	Ekon. Familj.	Sipërfaqja Km ²	Distanca ne KM(Mesatare)
Rurale	27	15,567	1,755	187,352	10
Rurale - Thelle	9	5,658	585	105,675	11
Total: Pa - mbuluara	36	21,225	2,340	293,027	10
Total	66	94,556	14,351	561,175	9
Gjenerimi i mbeturinave të vlerësuara					
Mbetjet e gjeneruara për person [kg/ban]-mesatarja	1.2 Kg				
Urbane	1.5 Kg				
Para - Urbane	1.2 Kg				
Rurale	1.0 Kg				
Rurale - Thelle	0.9 Kg				
Vlerësimi i gjenerimit të mbeturinave -të përlogaritura					
Totali i mbetjeve të gjeneruara [t/ditë]	113				
Totali i mbetjeve të gjeneruara [t/vit]	41,099				
Totali i mbetjeve të mbledhura 65 ton ne dite pune - [t/vit]	17,225				

4.2 Investimet e reja të nevojshme kapitale

Investimet e nevojshme për periudhën e planifikuar 2015-2020 janë në vlerë prej 1,600,600.00

• Kontejnerë 1.1 m3	195,600
• Mjetet e Transport & Garazhi	525,000
• Ndërgjegjesimi i Publikut	30,000
• Grumbullimi-Riciklimi	850,000

Investimet e planifikuara janë në varshmëri prej kohës dhe vlerës së investimeve, të cilat janë të ndara në dy periudha investive

- Periudha 2015/2017 në vlerë prej 1,555,600.00 e shprehur në përqindje 97.2% prej total investimeve të përgjithshme.
- Periudha 2017/2020 në vlerë prej 45,000.00 e shprehur në përqindje 2.8% prej total investimeve të përgjithshme 45,000.00

Investimet kapitale në menaxhimin e mbeturina vëne vlerë prej 705,600 EURO ose shprehur në përqindje 46.9%, janë të planifikuara në periudhën e parë investive 2015/2017. Investimet në periudhën e dytë 2018/2020 janë në vlerë prej 45.000 EURO e shprehur në përqindje 2.8% nga vlera totale e investimeve.

Investimet kapitale në Grumbullimin dhe Riciklimin në vlerë prej 850,000.00 Euro ose shprehur në përqindje 53.1% të cilat janë të planifikuara në periudhën e parë investive 2015/2017. Kjo kategori e investimeve është me interes të veçantë:

- duke mundësuar ofrimin e një kategorie të re të shërbimeve të cilat nuk janë ofruar më parë
- ndikimi i posaçëm në ambientin në përgjithësi
- zvogëlimin e kostove për menaxhimin e mbeturinave për sasinë e mbeturinave të riciklueshme (mbledhja, deponimi, transporti etj.)
- ofrimi i mundësive për kategoritë sociale të rrezikuara për gjenerimin e të hyrave për mbijetesë.

Investimet do të mundësojnë arritjen e objektivave të përcaktuar me strategjinë e Komunës së Gjakovës në menaxhimin e mbeturinave dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve, po ashtu edhe në ndikimin e drejtpërdrejtë në kostot e përgjithshme duke i reduktuar, bazuar në mjete të reja të cilat e rrisin efektivitetin e menaxhimit të mbeturinave.

4.2.1 Supozimet kryesore për investimet e nevojshme kapitale

Investimet e planifikuara për periudhën 2015-2020 bazohen në supozimet:

- Zëvendësimi i kontejnerëve 7.1m³ duhet të zëvendësohen me kontejnerët 1.1 m³.
- Raporti i zëvendësimit është 1 kontejner 7.1 m³ me 8 kontejner 1.1 m³.
- Investimet në kontejner **472 kontejnerë 1.1 m³** (8*59=472).
- Kontejnerët 7.1 m³ në aspektin higjienike janë jo të pastër për shfrytëzim. Transporti i kontejnerëve 7.1 m³ është tejet joefektiv, të cilët përmbajnë mesatarisht 650 kg mbeturina.
- Me zëvendësimin e kontejnerëve 7.1 m³ do të liroheshin edhe **tre kamionë** të cilët do të angazhohen për qëllime tjera
- Kontejnerët ekzistues 1.1 m³ që janë në numër 183 të zëvendësoheshin në periudhën 5 vjeçare pasi që në të kundërtën ata komplet do të ishin jo funksional.
- Investimi në zëvendësimin e kontejnerëve ekzistues dhe blerja e kontejnerëve të rinj gjatë periudhës 5 vjeçare:
 1. 472 Kontejner të rinj
 2. 183 Kontejner ekzistues –zëvendësimi për periudhën 5 vjeçare
 3. Total numri i kontejnerëve 655 për investim në periudhën 2015-2020
- Me 655 kontejnerë 1.1 m³ do të mundë të shfrytëzoheshin më mirë **3 kamionët Iveco** meqë shkalla e grumbullimit aktual për ditë është e ulët dhe që sillet nga 21 deri në 52 kontejnerë e që do të duhej të shkonte jo më pak se 65 kontejnerë për një cikël të grumbullimit.
- Kamioni Merc.Benz.2aks automatik 2226 me targa 03 801 -AM i vitit 1998 dhe me kapacitet të grumbullimit 9 ton do të duhej të zëvendësohej me një të ri.
- Komuna e Gjakovës praktikon grumbullimin e mbeturinave derë me derë për ekonomin familjare dhe një pjesë të mirë të biznesit dhe për ta realizuar një shërbim të tillë i duhet një kapacitet i kamionëve kompakte.
- Aktualisht kompania zotëron 4 kamion kompakte Hyundai dhe një kamion Ford të cilët janë të blerë në mes të vitit 2010-2013, në gjendje të mirë pune nuk paraqitet nevoja për investime shtesë.
- Investimi i një kamioni për stacionin e transferit. Kompania ka të angazhuar vetëm një kamion për bartje në deponinë në Landovicë, i cili është i mbingarkuar.
- Investimet e planifikuara janë të bazuara në çmimet e pajisjeve të vlerës së tregut, të krahasuara me investimet e kompanive si motra të cilat i kanë bërë këto investime.
- Investimet në një garazhi të ri për mirëmbajtjen e parkimin e mjeteve është paraparë në vlerë prej 300.000 Euro (1000 metra x 300 Euro), garazhi aktual nuk i plotëson kushtet e lokacionit si dhe kushteve për mirëmbajtje të mjeteve.
- Janë të planifikuara aktivitetet në ndërgjegjësimin e publikut në vlerë prej 6.000 EURO për ruajtjen dhe përkujdesjen ambientit me forma të ndryshme të aktivitetit promocionit.
- Investimet e planifikuara për mbledhjen e mbeturinave (përgatitja për riciklim) është e bazuar në synimin e KK Gjakovë për një investim të kësaj natyre. Vlera e përgjithshme e investimeve ka të bëjë me investim në infrastrukturë prej 100.000 EURO si dhe për një investim në pajisje në vlerë 750.000 EURO.

Investimet e planifikuara për periudhën 2015-2020 për kategoritë kryesore

Tabela 5: Supozimet kryesore për investimet e nevojshme kapitale

Nr	Kategoria	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Total	Ne %
I.	Kontejnerë 1.1 m3	70,800	70,800	27,000	27,000	-	-	195,600	12.2%
II.	Mjetet e Transport& Garazhi	225,000	300,000	-	-	-	-	525,000	32.8%
III.	Ndërgjegjësimi i Publikut	-	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000	30,000	1.9%
IV.	Grumbullimi-Riciklimi	-	100,000	750,000	-	-	-	850,000	53.1%
Total: Investimet		295,800	476,800	783,000	33,000	6,000	6,000	1,600,600	100.0%
Ne %		8.5%	29.8%	48.9%	2.1%	0.4%	0.4%	100.0%	

Figura 4: Paraqitja grafike e strukturës së investimeve kapitale

STRUKTURA E INVESTIMEVE PER PERIUDHEN 2015-2020




Tabela 6: Supozimet kryesore për investimet e nevojshme kapitale të ndara në dy periudha investive

Nr	Kategoria	2015/2017	2018/20120	Total	Ne %
I.	Kontejnerë 1.1 m3	168,600	27,000	195,600	12.2%
II.	Mjetet e Transporti& Garazhi	525,000	-	525,000	32.8%
III.	Ndërgjegjësimi i Publikut	12,000	18,000	30,000	1.9%
IV.	Grumbullimi-Riciklimi	850,000	-	850,000	53.1%
	Total: Investimet	1,555,600	45,000	1,600,600	100.0%
	Ne %	97.2%	2.8%	100.0%	

4.3 Mekanizmi i Vjeljes

Për momentin mungon një mekanizëm i qëndrueshëm i vjeljes i cili do të siguronte fonde të mjaftueshme nga faturat për financimin e menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave.

Operatori aktual i vetëm i licencuar i menaxhimit të mbeturinave ka të drejtën dhe obligimin e arkëtimit të faturave. Shkalla e arkëtimit nuk është e kënaqshme (67%) meqë një pjesë e qytetarëve dhe subjekteve juridike nuk shlyejnë obligimet, ndërsa kompania nuk posedon instrumente detyrues që konsumatorët të paguajnë faturën e mbeturinave.

PLMM parasheh ndryshime substanciale në sistemin e menaxhimit të mbeturinave e cila duhet të pasurohet edhe me një mekanizëm të qëndrueshëm të vjeljes. Pra siç është cekur edhe më lartë, nga viti 2016 Komuna e Gjakovës parasheh zonimin e qytetit në 4 zona dhe angazhimin e operatorëve ekonomik (publik apo privat) për grumbullimin e mbeturinave përbrenda këtyre zonave. Këta operatorë fillimisht do të kenë të drejtën e faturimit të konsumatorëve dhe vjeljes së faturave ndërsa Komuna do të miratojë tarifat e shërbimit.

Kalimi në sistemin e ri të faturimit dhe vjeljes duhet të paraprihet me instalimin e sistemit të ri të faturimit i cili për momentin nuk ekziston dhe i cili duhet të instalohet gjatë vitit 2016 apo edhe vitit 2017.

Komuna e Gjakovës përcaktohet që në periudhën e zbatimit të taksës së mbeturinave do të përfshijë instrumentin e kushtëzimit që do të vë në lëvizje të gjithë mekanizmat tjerë që do të mundësonin arkëtimin sa më të lartë të taksës së mbeturinave.

4.4 Buxheti komunal i dedikuar për menaxhimin e mbeturinave

Në kuadër të procesit të hartimit të PLMM-së ka parapare një varg aktivitete të cilat me vete bartin nevojë për shpenzime buxhetore të reja. Me konkretisht, Komuna ka paraparë që të themelohet "Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM)" i cili do të jetë pjesë e Drejtorisë për Shërbime Publike.


Në fakt, SMM do të jetësohet gjatë vitit 2016-2017, ku do t'i mundësoj Komunës të krijoj një sistem i cili do të jetë në gjendje të përmbush detyrat dhe përgjegjësitë e Komunës siç edhe e përcakton Ligji i ri mbi Mbeturinat.

SMM do të fuqizohet hap pas hapi dhe numri i stafit dhe buxheti do të rritet siç është paraparë në tabelën në vazhdim.

Tabela 7: Buxheti i implementimit të Sektorit të Menaxhimit të Mbeturinave

Pozita/Njësia	2016	2017	2018	2019	2020
Shefi i sektorit	1	1	1	1	1
Zyrtar për menaxhimin me të dhëna		1	1	1	1
Zyrtar i planifikimit dhe menaxhimit me hapësira publike	1	1	2	2	2
Zyrtar për marrëdhënie me klient	1	2	2	2	2
Total nr. i zyrtareve	3	5	6	6	6
Buxheti për pagat	13,800	22,200	26,400	26,400	26,400
Buxheti për pajisjen e Sistemit Informativ	20,340	2,400	2,400	2,400	2,400
Total buxheti	34,140	24,600	28,800	28,800	28,800

Figura 5: Paraqitja grafike e buxhetit për Sektorin e Menaxhimit të Mbeturinave



Ky plan parasheh që SMM gradualisht të marr përsipër detyrat që kanë të bëjnë me segmentin e mbeturinave dhe pastrimit, të cilat aktualisht janë të shpërndara nëpër njësi të ndryshme të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe drejtorive tjera.

4.5 Të hyrat e planifikuara

Në bazë të vlerësimeve për periudhën 2017-2020 kur edhe parashihet që Komuna e Gjakovës të merr tërësisht në kontroll sektorin për Menaxhimin e Mbeturinave, duke përfshi aktivitetet siç janë: planifikimi, organizimi, zbatimi dhe arkëtimi. Po ashtu është bërë një analizë për dy kategori kryesore: ekonomitë familjare dhe bizneset, nga tabelat e mëposhtme shihen qartë trendet të cilat kanë këto të hyra të planifikuara. Gjenerimi i këtyre të dhënave bazohet në këto elemente: tarifat ekzistuese, shkalla e arkëtimit, numri i ekonomive familjare dhe bizneseve.

Tabela 8: Të hyrat e planifikuara për amvisëri (2017-2020)

Zona	2017	2018	2019	2020
Zona 1	403,824	429,063	454,302	454,302
Zona 2	27,648	51,969	63,288	63,288
Zona 3	82,272	87,414	110,160	110,160
Zona 4	130,848	139,026	147,204	147,204
Total	644,592	707,472	774,954	774,954
Shkalla e vjeljes	80%	85%	90%	90%


Tabela 9: Të hyrat e planifikuara për biznese (2017-2020)

Zona	2017	2018	2019	2020
Bizneset	324,480	329,347	335,934	346,012
Rritja ne %		1.5%	2.0%	3.0%

Tabela 10: Të hyrat e planifikuara nga arkëtimi i mbeturinave në komunë (2017-2020)

Kategoria	2017	2018	2019	2020
Ekonomitë familjare	805,740	832,320	861,060	861,060
Biznese	324,480	329,347	335,934	346,012
Totali i të hyrave	1,130,220	1,161,667	1,196,994	1,207,072

Figura 6: Paraqitja grafike e të hyrave të projektuara (2017-2020)



5. Vlerësimi Strategjik Mjedisor

5.1 Qëllimi dhe qasja e VSM-së

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një proces sistematik për vlerësimin e pasojave mjedisore të një politike të propozuar, iniciative për një plan apo program me qëllim të sigurimit se ato janë përfshirë plotësisht dhe trajtohen në mënyrë të përshtatshme në fazën më të hershme të përshtatshme të vendimmarrjes, në të njëjtin nivel me konsideratat ekonomike dhe sociale.

Qëllimi kryesorë i VSM-së është sigurimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe që t'i kontribuoj promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm. VSM-ja synon përmirësimin e planit ose programit, duke sugjeruar objektivat apo strategjitë e reja, si dhe duke rishikuar strategjitë e propozuara dhe duke sugjeruar ato që mund të jenë më të mira në drejtim të mbrojtjes së mjedisit si dhe minimizimit dhe parandalimit të ndikimeve dhe rreziqeve në mjedis. VSM-ja si proces duhet të filloj në fazat fillestare të procesit të përgatitjes së planit dhe duhet të zhvillohet paralel me planin dhe të integrohet plotësisht në të.

Në Kosovë, VSM-ja është e rregulluar me Ligjin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (Ligji nr. 03/230), i cili përcakton kushtet, format dhe procedurat për zbatimin e VSM-së. Ky ligj është në përputhje me kërkesat e Direktivës së Bashkimit Evropian për Vlerësim Strategjik Mjedisor (Strategic Environmental Assessment Directive 2001/42/EC).

Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisorë kërkon që procedura e VSM-së të përbëhet nga:

- Përgatitja e një raporti të VSM-së në lidhje me ndikimet e konsiderueshme të draftit të planit ose programit (PP);
- Konsultimi i organeve relevante dhe publikut të gjerë për draftin e Planit ose Programit dhe raportin shoqërues të VSM-së;
- Marrjen në konsideratë të raportit për VSM dhe rezultateve të konsultimit në vendimmarrje;
- Komunikimin e rezultateve të VSM-së dhe përfshirjen e rezultatit të saj në Planin ose Programin përkatës.
- Sipas Ligjit Nr. 03/230, VSM-ja është e detyrueshme për Planet dhe Programet si në vijim:
- Planet dhe Programet që janë të përgatitura për planifikim hapësinor, planifikim të qytetit, shfrytëzim të tokës, bujqësi, pylltari, peshkatori, gjueti, energji, industri, miniera, komunikacion, **menaxhim të mbeturinave**, menaxhim të ujërave, telekomunikacion, turizëm, dhe të përbej kornizën për projektet e ardhshme të zhvillimit të cilat i nënshtrohen VNM-së sipas Ligjit për VNM;
- PP-të të cilat duke marrë në konsideratë lokacionin në të cilin realizohen, mund të ndikojnë në zonat e mbrojtura të natyrës, mbi habitatet natyrore si dhe në florën dhe faunën e egër.
- Llojet tjera të PP-ve, vetëm nëse ato janë përcaktuar përmes “ekzaminimit” që kanë gjasa të kenë ndikime të konsiderueshme në mjedis
- Modifikimet e vogla të PP-së si dhe PP-ja për zonë të vogël në nivel lokal, vetëm nëse ato janë përcaktuar përmes “ekzaminimit” që kanë gjasa të kenë ndikime të konsiderueshme në mjedis.

Pra sikurse është e specifikuar më lartë dhe në përputhje me nenin 4 pikën 2 të Ligjit të VSM-së, dhe Planet e Menaxhimit të Mbeturinave kërkojnë përgatitjen e raportit të VSM-së. Prandaj edhe për Planin Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave 2015-2020, raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor është i detyrueshëm për komunën e Gjakovës.

5.2 Vlerësimi i masave dhe politikave të propozuara

Vlerësimi i masave dhe politikave të propozuara ka për qëllim të testoj synimet e Planit Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave 2015-2020 të Komunës së Gjakovës, të përshkruara në kapitullin 2 të planit, në relacion me objektivat e VSM-së për të identifikuar ndërveprimet dhe konfliktet potenciale.

Qëllimet kryesore të vlerësimit/analizës së përputhshmërisë së synimeve të Planit Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave 2015-2020, me objektivat e mjedisore të VSM-së, janë:

- Testimi nëse të gjitha objektivat e VSM-së po trajtohen sipas planit, d.m.th. nëse për secilin objektiv të VSM-së ka së paku një objektiv potencialisht në përputhje me objektivin e planit;
- Theksimi i mospërputhjeve dhe konflikteve potenciale, dhe rekomandimi i mënyrave për të zbatuar planin në mënyrë që të shmangen konfliktet e tilla;
- Theksimi i ndërveprimeve potenciale dhe sugjerimi i mënyrave për t'i avancuar dhe shfrytëzuar ato në plan.

Komentet në lidhje me të gjeturat kryesore nga përputhshmëria mes synimeve të Planit Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave të Komunës së Gjakovës dhe objektivave të VSM-së janë si vijon:

Synimi 1: Të rritet shkalla e mbulueshmërisë së shërbimit të grumbullimit të mbeturinave nga 77.6 % deri në 100%

- Ky synim ka për qëllim të rrisë shkallën e mbulueshmërisë së shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në të gjithë territorin e komunës.
- Kjo do të ketë ndikim të rëndësishëm pozitiv sidomos në objektivin 4 të VSM-së (Eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave) dhe në objektivin 9 të VSM-së (Përmirësimi i shëndetit publik dhe zvogëlimi i rrezikut nga ndotja), meqenëse me shtrirjen e shërbimit në të gjithë territorin e komunës do të krijohen kushte për eliminimin e deponive ilegale dhe do të përmirësojnë kualitetin e jetës së qytetarëve.
- Ky synim do të ketë ndikim pozitive indirekte edhe në objektivat 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8, meqenëse do të ndikoj në mënyrë indirekte në zvogëlimin e emetimeve dhe mbeturinave në ujë dhe tokë si dhe në zvogëlimin e mbeturinave në parqe dhe në zona tjera të natyrës.

Synimi 2: Të rritet shkalla e përgjithshme e grumbullimit të mbeturinave nga 66% deri në 90 %

- Ky synim ka për qëllim të rrisë shkallën e përgjithshme të grumbullimit të mbeturinave në të gjithë territorin e komunës.
- Kjo do të ketë ndikim pozitiv domethënës sidomos në objektivin 9 të VSM-së (Përmirësimi i shëndetit publik dhe zvogëlimi i rrezikut nga ndotja) meqenëse rritja e shkallës së përgjithshme të grumbullimit të mbeturinave është e lidhur ngushtë me përmirësimin e kualitetit të jetës.
- Ky synim do të ketë ndikim pozitiv indirekt edhe në objektivat 3, 5, 6, 7 dhe 8, meqenëse ky do të ndikoj në mënyrë indirekte edhe në zvogëlimin e emetimeve në ujë, ajër dhe tokë, në zvogëlimin e mbeturinave në parqe dhe në zona tjera të natyrës si dhe është në funksion të eliminimit të deponive ilegale dhe në zvogëlimin e gjenerimit të mbeturinave përmes riciklimit dhe ripërdorimit të tyre.

Synimi 3: Të zvogëlohet shkalla e hedhjeve ilegale të mbeturinave nga 49% në 10%

- Ky synim ka për qëllim të zvogëlojë shkallën e hedhjes ilegale të mbeturinave deri në nivelin 0% në të gjithë territorin e komunës.
- Synimi do të ketë ndikim pozitiv domethënës sidomos në objektivin 4 të VSM-së (Eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave) dhe në objektivin 6 të VSM-së (Mbrojtja e tokës nga ndërrimi i destinimit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i saj), meqenëse me zvogëlimin e shkallës së hedhjes së mbeturinave në nivelin 0% në të gjithë territorin e komunës do të krijohen kushte për eliminimin e plotë të deponive ilegale dhe në mbrojtjen e tokës nga ndërrimi i destinimit të saj.
- Ky synim do të ketë ndikim pozitiv indirekt edhe në objektivat 2, 3, 5, 7, 8 dhe 9, meqenëse synimi do të ndikoj në mënyrë indirekte në zvogëlimin e emetimeve dhe mbeturinave në ujë (rrjedhat sipërfaqësore) dhe në tokë, emetimeve në ajër, në zvogëlimin e mbeturinave në parqe dhe në zona tjera të natyrës si dhe do të kontribuoj në përmirësimin e standardit të jetës.

Synimi 4: Të zvogëlohet shkalla e deponimit final të mbeturinave nga 95% në 85%

- Ky synim ka për qëllim të zvogëlojë shkallën e deponimit final të mbeturinave për 10%.
- Synimi nuk pritet të ketë ndikim domethënës në asnjë nga objektivat e VSM-së, meqenëse deponimi i mbeturinave bëhet jashtë territorit të komunës, ndërkohë që stacioni i transferim do të mbetet ende në funksion.
- Megjithatë ky synim do të ketë ndikim pozitiv indirekt në objektivat 1 dhe 2 meqenëse ky synim do të ndikoj në mënyrë indirekte në zvogëlimin e emetimeve në ajër dhe në emetimet e gazrave serrë.
- Ndikimi i këtij synimi do të mbetet ende me ndikim të pa definuar (Ndikime pozitive dhe negative), për objektivin 3 të VSM-së (Zvogëlimi i shkarkimeve në ujëra sipërfaqësore) dhe objektivin 6 të VSM-së (Mbrojtja e tokës nga ndërrimi i destinimit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i saj), meqenëse zvogëlimi i sasisë së mbeturinave të deponuara vetëm për 10%, nuk pritet të ketë ndonjë ndikim në përmirësimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe as në përmirësimin e gjendjes së tokës në zonën përreth, për faktin se deponia do të vazhdojë së funksionari përkundër zvogëlimit të ndjeshëm të mbeturinave të deponuara.
- Ndikimi në cilësisë së ujërave sipërfaqësore, nëntokësore dhe në tokë do të mbetet ende prezente edhe për shkak të aktivitetit që do të jetë prezent në lokacionin e transferit të mbeturinave.

Synimi 5: Të rritet shkalla e riciklimit dhe ripërdorimit të mbeturinave nga 5% në 23%

- Ky synim ka për qëllim të rrisë shkallën e përgjithshme të riciklimit të mbeturinave për 10% në të gjithë territorin e komunës.
- Edhe pse rritja e kësaj shkalle të riciklimit është vetëm për 10%, kjo do të kishte ndikim pozitiv domethënës sidomos në objektivin 5 të VSM-së (Zvogëlimi i gjenerimit të mbeturinave përmes riciklimit dhe ripërdorimit) meqenëse rritja e shkallës së përgjithshme të riciklimit do të ishte në funksion të zvogëlimit të gjenerimit të mbeturinave përmes riciklimit dhe ripërdorimit.
- Ky synim do të ketë ndikim pozitiv indirekt edhe në objektivat 1 dhe 2, meqenëse do të ndikojë në mënyrë indirekte në zvogëlimin e emetimeve në ajër dhe në zvogëlimin e emetimeve të gazrave serrë, për faktin se do të zvogëlohet sasia e mbeturinave të deponuara dhe në mënyrë indirekte do të zvogëlohen edhe emetimet në ajër dhe emetimet e gazrave serrë nga sektori i mbeturinave.

5.3 Rekomandimet dhe propozimet e monitorimit

Bazuar në vlerësimin e masave dhe politikave të propozuara nga testimi i synimeve të Planit Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave 2015-2020 të Komunës së Gjakovës, me objektivat mjedisore të VSM-së dhe duke analizuar të gjeturat kryesore nga analiza e matricës së përputhshmërisë ku janë identifikuar ndërveprimet dhe konfliktet potenciale dhe me qëllim të minimizimit të tyre, propozohen të zbatohen këto rekomandime për të përmirësuar përputhshmërinë ndërmjet planit dhe objektivave të VSM-së:

Tabela 2: Plani i monitorimit të zbatimit të objektivave të VSM-së

Objektivi i VSM-së	Qasja e monitorimit (Treguesit e monitorimit)	Shpeshtësia e propozuar e monitorimit	Autoriteti përgjegjës ku do të sigurohen të dhënat
O1: Mbrojtja e ajrit nga ndotja dhe zvogëlimi i ndotësve në ajër	Monitorimi i cilësisë së ajrit dhe i emetimeve në ajër	çdo vit	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës/ Instituti Hidrometeorologjik
O2: Zvogëlimi i lirimit të emetimeve të gazrave serrë	Inventari i emetimeve të gazrave serrë nga sektori i mbeturinave Sasia e mbeturinave që dërgohet në deponi	çdo 2 vite	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Kompania regjionale e mbeturinave
O3: Zvogëlimi i shkarkimeve në ujëra sipërfaqësore	Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe i shkarkimeve të ujërave në zonën e transferit të mbeturinave dhe afër deponive ilegale	çdo 2 vite	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës/ Instituti Hidrometeorologjik
O4: Eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave	Numri i deponive ilegale të eliminuara dhe të rehabilituara Numri i vendbanimeve (ose i ekonomive familjare) të reja të përfshira në sistemin për grumbullimin e mbeturinave	çdo vit	Inspektorati dhe Drejtoria për shërbime publike e Komunës së Gjakovës Kompania Regjionale e Mbeturinave
O5: Zvogëlimi i gjenerimit të mbeturinave përmes riciklimit dhe ripërdorimit	Sasia e mbeturinave të ricikluara dhe ripërdorura Numri i komposterëve të shpërndarë Numri i kompanive të licencuara për riciklim të mbeturinave	çdo 2 vite	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Komuna e Gjakovës Kompanitë ricikluese
O6: Mbrojtja e tokës nga ndërrimi i destinimit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i saj	Sipërfaqet e tokës të rehabilituara nga deponitë ilegale dhe nga aktivitetet tjera	çdo 3 vite	MMPH/AMMK

O7: Mbrojtja dhe konservimi i natyrës dhe biodiversitetit	Numri i zonave të reja të natyrës të përfshira në mbrojtje	çdo vit	Komuna e Gjakovës
	Numri i zonave me lloje të rralla bimore dhe shtazore		Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës / Instituti për Mbrojtjen e Natyrës
	Numri i zonave të identifikuar të rëndësishme me lloje dhe habitate potenciale për tu përfshirë në mbrojtje		
O8: Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbra në zonat urbane dhe mirëmbajtja e tyre	Numri (sipërfaqja) i parqeve të reja dhe zonave të gjelbra në zonat urbane	çdo 1-2 vite	Komuna e Gjakovës
O9: Përmirësimi i shëndetit publik dhe zvogëlimi i rrezikut nga ndotja	Numri i sëmundjeve ambientale (sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes, sëmundjet diarike etj)	çdo 1-2 vite	Qendra e mjekësisë familjare në Gjakovë
	Cilësia e ujërave të pijes		Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik

Ndërsa me qëllim të monitorimit të zbatimit të objektivave të Vlerësimit Strategjik Mjedisor, propozohet që të zbatohet një plan i monitorimit i cili do të përmbante: qasjen e monitorimit (treguesit e monitorimit), shpeshtësinë për monitorimin e treguesve si dhe autoritetet përgjegjëse nga ku do të siguroheshin të dhëna nga monitorimi. Në tabelën 2 është propozuar një plan i monitorimit i cili do të mund të plotësohej edhe me tregues tjerë varësisht nga nevoja dhe ndryshimi i objektivave të VSM-së gjatë procesit të konsultimit me publikun dhe organet relevante.

6. Ndërgjegjësimi i publikut

6.1 Strategjia e Komunikimit të Marketingut

Përmbledhje

Kjo strategji e planit të komunikimit të marketingut është e bazuar në analizat dhe kërkimet e detajuara të raporteve dhe të dhënave konkrete mbi gjendjen aktuale të menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Gjakovës. Ky plan adreson aktivitetet vjetore për menaxhimin efektiv të mbeturinave me qëllim të reduktimit të sasisë së mbeturinave, eliminimit të deponive ilegale, dhe edukimin e publikut përmes promovimit të 3R (Reduktimin, Ri-Përdorimin dhe Riciklimin).

Aktivitetet e propozuara të komunikimit do të zhvillohen në kuadër të këtyre parimeve të përcaktuara më poshtë:

- I gjithë komunikimi duhet të jetë i thjeshtë, i qartë, i hapur dhe efektiv i cili lejon dialog nga të dyja anët.
- Toni i komunikimit duhet të jetë i ndershëm, pozitiv dhe i saktë.
- Të gjitha mesazhet e komunikimit duhet zhvilluar me fleksibilitet, për të mundësuar zhvillimin e tyre në të gjitha planet e evoluimit të Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave.
- Krijimi i një marke/identiteti të qartë dhe të qëndrueshëm për të gjitha kanalet e komunikimit, përmes të cilave njerëzit mund të lidhen dhe të kuptojnë mesazhet tona kyçe.
- Përdorimi i materialeve për të mësuar praktikrat tjera të suksesshme, dhe promovimi i materialeve promovuese të fushatës në konteste kombëtare me qëllim të ndërveprimit më të madh
- Përdorimi i produkteve/materialeve ekologjike miqësore, për prodhimin e të gjitha materialeve promovuese dhe publicitare.
- Përfshirjen e të gjitha grupeve të audiencës si audiencë prioritare e kampanjës, duke përfshirë grupet e ndryshme të moshës, gjinisë, statusit socio – ekonomik, dhe grupeve tjera etnike.
- Prodhimi i materialeve promovuese specifike për çdo grup specifik, materiale të cilat do të jenë të përshtatshme për nevojat e tyre.
- Iniciativat/aktivitet kryesorë do të mbështeten me publicitet të rregullt për të siguruar inkurajimin dhe motivimin e vazhdueshëm të audiencës për të ndryshuar/përimtuar sjelljet e tyre në lidhje me menaxhimin e mbeturinave.
- Shumica e komunikimeve do të jenë të synuara për audiencë specifike për shkak se ky projekt ka për qëllim që në mënyrë efektive të ndryshoj më sjelljen e audiencës në përgjithësi.
- Plani strategjik i komunikimit do të jetë vazhdimisht në koordinim dhe aprovim me koordinatorët e projektit.
- Monitorimi dhe vlerësimi i mjeteve të komunikimit, dhe përmirësimi i taktikave të komunikimit, aty ku është e nevojshme.

6.1.1 Publiku/Akterët e Synuar

Bizneset

- Korporatat dhe bizneset private të Komunës së Gjakovës
- Shoqatat e bizneseve në Komunën e Gjakovës
- Shoqatat e bizneseve të Odës Ekonomike të Kosovës
- Punëtorët

Komuniteti:

- Qytetarët e Komunës së Gjakovës
- Gratë
- Familjet
- Të rinjtë
- Përfaqësues të mediave lokale
- Përfaqësues të OJQ-ve

6.1.2 Mesazhet kyçe për promovim

Komunikimi i marketingut duhet të promovojë këto mesazhe kyçe të kampanjës:

- Parandalimi dhe reduktimi i mbeturinave është çështje shumë e rëndësishme për të gjithë qytetarët e Komunës së Gjakovës.
- Ripërdorimi dhe Riciklimi sa më i madh i mundshëm i mbeturinave.
- Promovimi i përfitimeve të ambientit tek të cilat mund të përfitojmë nga menaxhimi efektiv i mbeturinave.

7. Plani i Veprimit

7.1 Qartësimi i përgjegjësive të qytetarëve, bizneseve dhe qeverisjes lokale

Komuna e Gjakovës, qytetarët dhe bizneset afariste duhet të ndërtojnë një sistem të duhur të MM, duke marrë përgjegjësitë secili nga të përmendurit më lartë:

Qytetarët

Qytetarët paguajnë taksën brenda afateve të caktuara nga Komuna e Gjakovës.

Respektimi i rregullave të shkarkimit

- Qytetarët përfillin mënyrat e shkarkimit të caktuara nga Komuna. Qytetarët të cilët jetojnë në ato pjesë të qytetit ku bëhet grumbullimi i veçantë i kartonëve dhe metaleve, i ndajnë gjërat e riciklueshme në mënyrë të duhur dhe konform udhëzimeve të dhëna nga Komuna.

Bashkëpunimi aktiv në Plan

Qytetarët në mënyrë aktive bashkëpunon rreth masave të ndërmarra nga qeveria për implementimin e planit të menaxhimit të mbeturinave.

Bizneset Afariste

Parimi ndotësi paguan

Kompanitë afariste të shkallës së ulët që shkarkojnë mbeturinat bashkë me ekonomitë familjare duhet të paguajnë brenda afateve të caktuara nga komuna.

Kompanitë afariste të shkallës së lartë, individualisht duhet të bëjnë një kontratë për shërbimin e grumbullimit dhe transportimit me ofruesin e shërbimeve të licencuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Prandaj, kompanitë afariste të shkallës së lartë duke kontraktuar shërbimin e grumbullimit të mbeturinave, në baza vjetore duhet të raportojnë në komunë për sasinë e shkarkuar të mbeturinave.

Bizneset do të marrin pjesë në mënyrë aktive në aktivitete për reduktim, riciklim dhe ripërdorim duke qenë bartës apo mbështetës të aktiviteteve specifike.

Qeverisja Lokale

Shkarkimi i duhur i mbeturinave

Komuna bënë përpjekje për të krijuar një shërbim grumbullimi dhe transportimi stabil duke marrë parasysh efikasitetin, mjedisin dhe higjienën. Komuna përpiqet të minimizoj mbeturinat përmes aktiviteteve 3R bashkë me qytetarët dhe kompanitë afariste.

7.2 Përmbledhje e Planit të Zbatimit 2015-2020

Aktiviteti	Përgjegjës	2015				2016				2017				2018				2019				2020			
Plani i menaxhimit të mbeturinave		Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4
Përfundimi i planit	GP/DEMOS																								
Diskutimi publik	DSHP/GP																								
Aprovimi në Asamblen Komunale	DSHP/GP																								

Riorganizimi i Drejtorisë–vendosja e sistemit institucional për menaxhim me mbeturina

Formimi i strukturës organizative dhe përkrahimi i vendeve të punës	DSHP																								
Planifikimi buxhetor	DSHP/DBF																								

Aktiviteti	Përgjegjës	2015				2016				2017				2018				2019				2020			
Vendosja e sistemit të taksave, tarifave dhe i inkasimit të mjeteve		Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4
Taksa dhe tarifa për mbeturina - përcaktimi i modelit të inkasimit	DSHP/ DBF																								
Taksa dhe tarifa për mbeturina të bëhet planifikim i buxhetor	DBF/ DEMOS																								
Përcaktimi dhe rishiqimi i taksës dhe tarifave të shërbimit	DSHP																								
Furnizimi me software adekuat dhe implementimi i inkasimit	DBF/ DSHP/ DEMOS																								
Implementimi i inkasimit të taksës dhe tarifës mbi mbeturina	DSHP/ DBF																								

Aktiviteti	Përgjegjës	2015				2016				2017				2018				2019				2020			
Menaxhimi me Mbeturina dhe Stacioni Transfer		Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4
Përcaktimi i zonave të operimit	DSHP																								
Ofrimi i shërbimit të grumbullimit në zonat e operimit (inkasimi i shërbimit, realizohet nga operatori që e ofron shërbimin e grumbullimit)	DSHP / ZP																								
Dhënia në shërbim e stacionit transfer	DSHP / KK																								
Kontraktimi i operatorit për menaxhim me stacionin transfer	DSHP																								
Funksionalizimi i menaxhimit të Stacionit Transfer të mbeturinave	DSHP																								
Rregullimi i pikave të grumbullimit të mbeturinave në hapësira publike	DSHP																								
Pilot projektet																									
Kompostimi në vendburim	DSHP																								
Ndarja e mbeturinave në burim/ shkolla	DSHP																								
Grumbullimi i mbeturinave me qese	DSHP																								
Grumbullimi i mbeturinave me përmasa të mëdha	DSHP																								

Periudha kohore për zbatimin e aktiviteteve të paraqitura në tabelë është planifikuar të realizohet gjatë vitit 2015-2020, por kjo nuk do të thotë që ka mundësi që disa nga aktivitetet të realizohen në afate me të shkurta kohore.

8. Monitorimi dhe rishikimi

Është e rëndësishme të monitorohet progresi dhe efektiviteti i masave që janë ndërmarrë.

Monitorimi i zbatimit mund të konsiderohet përfshirja e tre elementëve:

- Eficienca e zbatimit – monitorimi i performancës
- Efektiviteti i këtyre veprimeve – monitorimi i përputhshmërisë
- Identifikimi i nevojave të reja – reagimi ndaj ndryshimit

Qeveritë lokale, sa i përket zbatimit të Planit Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave, duhet të mbështeten nga Institucionet Qendrorë, duke përfshirë këtu Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit, Agjencionin Pyjor si dhe organizatat e ndryshme joqeveritare.

8.1 Përcaktimi i treguesve të performancës dhe burimet e verifikimeve

Objektivat	Aktivitetet	Autoritetet Përgjegjëse	Indikatorët e Suksesit	Impakti
1. Planifikimi i Menaxhimit të Mbeturinave	Dërgimi i PLMM-së në Kuvendin Komunal për miratim Rishikimi dhe përditësimi i PLMM në përputhje me Planin operativ të përditësuar përfshirë edhe planin e monitorimit	Komuna e Gjakovës Drejtoria e Shërbimeve Publike Sektori i menaxhimit të mbeturinave	Numri i votave në favor të miratimit të PLMM-së	Hyrja në fuqi dhe zbatimi i PLMM-së Përmirësim i shërbimeve të MM dhe mjedis më i pastër
